

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6523  
E hënë, 31 janar 2022  
çmimi 0.40

Kosova regjistron  
2 390 raste të reja me  
koronavirus | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PARALAJMËROHEN PROTESTA TË REJA KUNDËR SHTRËNJTIMIT  
TË ENERGJISË ELEKTRIKE | FAQE 4-5

## KËRKOHEM REFLEKTIM NGA ZRRE-ja



Subjektet e ndryshme politike dhe shumë qytetarë i kanë kërkuar Zyrës së Rregullatorit të Energjisë që sot (e hënë) ta refuzojë propozimin për shtrenjtimin e energjisë elektrike. Sipas tyre, ZRrE-ja duhet të reflektojë dhe t'i marrë parasysh vërejtjet e shumta të opinionit publik për vendosjen e tarifave. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë janë paralajmëruar protesta dhe aksione të reja për ta kundërshtuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike

### AKTUALE



MAQEDONIA E VERIUT REGJISTRON  
21 VIKTIMA NGA KORONAVIRUSI | F. 2

NATO NUK DO TË DËRGOJË  
TRUPA NË UKRAINË NË RAST TË  
PUSHTIMIT RUS | F. 2

ANTIDROGA E POLICISË ZBULON  
MBI 10 KILOGRAMË DROGË TË  
FSHEHUR NË NJË BUNKER | F. 6

PËRKUJTOHEN DËSHMORËT HYSNI  
MAZREKU DHE ALI KRYEZIU | F. 6

### EKONOMI



AS MILIARDAT NUK E LARGOJNË  
VARËSINË NGA THËNGJILLI | F. 7

### SPORT



KAMPIONËT VAZHDOJNË  
ME FITORE, TREPÇA TRIUMFON  
NË DERBI NDAJ PEJËS | F. 10

Kurti: Do të investojmë për zhvillimin e aviacionit ushtarak | FAQE 3



ESCOBARI DHE LAJÇAKU VIJNË SOT NË KOSOVË,  
PRITEN MESAZHE TË QARTA RRETH DIALOGUT | FAQE 5

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Maqedonia e Veriut regjistron 21 viktima me koronavirus

**SHKUP, 30 JANAR** - Maqedonia e Veriut ka regjistruar të dielën 21 viktima dhe 1 254 raste të reja me koronavirus. Të dhënat e Institutit të Shëndetit Publik bazohen në testimin e 5 082 mostrave. Pozitiviteti i rasteve është 24,7 për qind. Shtatë nga viktimat janë regjistruar në Shkup, nga tre në Kavadar dhe Strumicë, dy në Prilep dhe nga një në Strugë, Kumanovë, Tetovë, Kërçovë, Negotinë dhe Manastir. Sipas raportit të publikuar, nëntë nga viktimat kanë

qenë të vaksinuara, ndërsa 12 të tjera me sëmundje të tjera shoqëruese. Numri total i viktimave me koronavirus ka arritur në 8 383. Nga 1 254 personat e infektuar, 655 janë regjistruar vetëm në Shkup, ndërsa numri i rasteve aktive në nivel të Maqedonisë së Veriut është 20 114. Ministri i Shëndetësisë, Bekim Sali, ka paralajmëruar ndryshime në përbërjen e Komisionit për Sëmundje Infektive, zgjerimin e këtij trupi edhe



me specialistë të klinikave të tjera “për një menaxhim sa më efikas me pandeminë e koronavirusit”.

Ai nuk e ka përjashtuar mundësinë e ndryshimit të protokollit për evidentimin e viktimave, përkatësisht

mostestim për Covid-19 të pacientëve që vdesin nga sëmundje të tjera shoqëruese. Numri i lartë i viktimave në Maqedoninë e Veriut i dedikohet protokollit, i cili, sipas specialistëve të shëndetësisë, dallon nga ai i vendeve të tjera. Paralajmërimet ministri Sali i ka bërë gjatë marrjes së vaksinës së tretë dhe me këtë rast ka bërë thirrje për vaksinimin e popullatës. Deri më tani me nga dy doza janë vaksinuar rreth 864 000 persona apo rreth 48 për qind e popullatës.

## NATO nuk do të dërgojë trupa në Ukrainë në rast të pushtimit rus

**BRUKSEL, 30 JANAR** - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se aleanca ushtarake e Perëndimit nuk do të dërgojë trupa luftarake në Ukrainë në rast se Rusia pushton këtë shtet. “Ne nuk planifikojmë të dërgojmë trupa luftarake të NATO-s në Ukrainë... ne jemi duke u fokusuar në ofrim të mbështetjes”, ka thënë Stoltenberg në një intervistë për transmetuesin britanik, BBC, më 30 janar. “Ka dallim në mes të një vendi që është anëtar i NATO-s dhe një vendi të vlefshëm partner siç është Ukraina”. Komentet e Stoltenbergut kanë ardhur në kohën e rritjes së tensioneve në mes të NATO-s dhe Moskës, pasi Rusia ka

pozicionuar më shumë se 100 mijë trupa afër kufirit të Ukrainës, çka ka rritur shqetësimet për pushtim. Kremli, i cili ka mohuar planet për pushtim sikurse më 2014 kur ka marrë kontrollin e Gadishullit ukrainas të Krimesë, ka insistuar në negociatat e fundit me Uashingtonin dhe NATO-n për disa garanci që Ukraina dhe ish-vendet e Bashkimit Sovjetik të mos anëtarësohen në aleancën e Perëndimit. Ukraina synon anëtarësimin në NATO, por ende nuk ka plan veprimi për anëtarësim, çka do t'i prezantonte kushtet për t'u bërë pjesë e saj. NATO-ja ka thënë se politika e saj “për dyer të hapura” nuk negociohet dhe Uashingtoni ka



theksuar se shtetet sovraane kanë të drejtë të vendosin vetë për aleancat e tyre ushtarake. Pas përgjigjes së ShBA-së ndaj kërkesave të Moskës, presidenti rus Vladimir Putin i ka thënë homologut të tij francez Emmanuel Macron më 28 janar se i është dukur se

Perëndimi i ka “injuar” shqetësimet e Moskës për siguri. NATO-ja ka thënë se është e përgatitur për ta rritur praninë në vendet anëtare të Evropës Lindore nëse Rusia pushton Ukrainën dhe disa vende anëtare të aleancës kanë ofruar

pajisje ushtarake për Kievin. Uashingtoni ka thënë se synon zgjidhje diplomatike për krizën dhe se Rusia duhet ta largojë praninë ushtarake afër kufirit me Ukrainën. Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, ka thënë se pret ta takojë Sekretarin amerikan të Shtetit, Antony Blinken, në javët e ardhshme, për një tjetër raund negociatash, mirëpo Putini do të vendosë si të përgjigjet ndaj pozicionit amerikan për kërkesat e Moskës. Moska ka mbështetur separatistët në luftën në lindje të Ukrainës, e cila ka marrë jetën e më shumë se 13 200 personave prej vitit 2014, vitin e njëjtë kur Rusia ka aneksuar Krimenë.

## Herzog bëhet presidenti i parë izraelit që viziton Emiratet

**JERUSALEM, 30 JANAR** - Presidenti izraelit Isaac Herzog ka udhëtuar në Emiratet e Bashkuara Arabe të dielën, duke shënuar vizitën e parë të ndonjë presidenti në këtë shtet të Gjirit. Herzog është shoqëruar nga gruaja e tij në vizitën dyditore. Ai do të takohet me Princin e kurorës së Abu Dabit dhe udhëheqësin de facto të Emirateve të Bashkuara

Arabe, Mohammed bin Sajid Al Nahjan. “Unë sjell me vete bekimet dhe mesazhin e paqes për njerëzit e gjithë rajonit”, ka thënë Herzog. Përgjatë vizitës, Herzog do të takohet edhe me komunitetin e hebrejve, është thënë në deklaratën e lëshuar nga zyra e tij. Në muajin dhjetor, kryeministri izraelit Naftali Bennett është bërë kryeministri i parë i Izraelit që ka vizituar Emiratet.



Izraeli ka nënshkruar marrëveshje me Emiratet dhe Bahrejin më 2020 për të

krijuar marrëdhënie diplomatike. Prej atëherë, dy shtetet arabe,

dhe vendet fqinje, Egjipti dhe Jordania, kanë mbajtur marrëdhënie diplomatike me Izraelin. Vitin e kaluar Emiratet kanë hapur ambasadë në qytetin Tel Aviv të Izraelit. Përgjatë kësaj periudhe janë krijuar edhe fluturime direkte mes dy shteteve. Arsyet ekonomike besohet se janë kryesoret për këtë qasje afruese, mirëpo këto shtete janë duke formuar edhe aleancë kundër Iranit.



## Kosova regjistron 2 390 raste të reja me koronavirus

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 JANAR - Ministria e Shëndetësisë në Kosovë ka njoftuar se të dielën, më 30 janar, janë regjistruar 2 390 raste të reja me koronavirus, pas testimit të 10 336 mostrave.

Shkalla e pozitivitetit nga mostrat e marra është 23.12 për qind.

Në 24 orët e fundit nuk ka pasur viktima me këtë virus.

Autoritetet shëndetësore kanë njoftuar edhe se 1 291 persona janë shëruar derisa 35 051 persona janë ende aktivë në

koronavirus.

Kosova ka nisur fushatën e vaksinimit kundër koronavirusit në mars të vitit të kaluar. Prej atëherë janë dhënë mbi 1.7 milion doza të vaksinës.

Deri më tani me dy doza të vaksinës janë imunizuar 804 801 persona apo 44 për qind e popullsisë.

Qytetarët në Kosovë mund të marrin vakcina të kompanive "Pfizer/BioNTech" dhe "AstraZeneca".

Doza përforcuese e vaksinës mund të merret pas tre muajve të marrjes së dozës së dytë. Qeveria

e Kosovës ka miratuar më 21 janar masa të reja për luftim të pandemisë.

Sipas vendimit të qeverisë, qytetarët që hyjnë në Kosovë duhet të jenë të vaksinuar plotësisht dhe ta kenë edhe dozën përforcuese, duhet të kenë test negativ të llojit PCR, të vlefshëm për 48 orë.

Kufizimi i qarkullimit do të aplikohet nga ora 22:00 deri në orën 05:00.

Bizneset e gastronomisë mund ta zhvillojnë aktivitetin e tyre nga ora 05:00 deri më 21:00.



## Kurti: Do të investojmë në zhvillimin e aviacionit ushtarak

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 30 JANAR - Kryeministri Albin Kurti dhe ministri i Mbrojtjes Armend Mehaj pritën në takim tre pilotët e Kompanisë së Helikopterëve të Gardës Kombëtare të Forcës së Sigurisë së Kosovës: toger Afrim Zabelin, toger Krenar Vocën, toger At dhe Hasanin. Po ashtu, të specializuarin për monitorim dhe orientim ajror, nëntoger Sunaj Shalën, dhe dy inxhinierë të helikopterit, rreshter Behar Zeqirin dhe rreshter Labinot Gashin. Sipas njoftimit, Kurti i falënderoi ata për kontributin dhe rolin që kanë pasur deri tani dhe që do ta kenë edhe në të ardhmen për avancimin e Kompanisë së

Helikopterëve të FSK-së.

Ai theksoi se Ushtria e Kosovës është në filllet e gjinisë së aviacionit dhe se avancimin e shih të rëndësishëm edhe për nevojat ushtarake, por edhe për ato shtetërore. "Shkollimi dhe pajisjet janë të rëndësishme, dhe do të investojmë si shtet në të dyja", shtoi ai.

Pilotët i treguan kryeministrit për shkollimin që kanë kryer, për sfidat që kanë pasur e që i kanë.

Tre pilotët janë specializuar në Akademinë Ushtarake në Turqi ashtu sikurse edhe dy inxhinierët e helikopterit, ndërsa nëntogeri Shala ka specializuar për monitorim, orientim, udhëzim e radar në Akademinë Ushtarake të Kroacisë "Dr. Franjo Tugjman".

## LB: Kosova t'ua thotë ndërkombëtarëve se e pranon Asociacionin nëse një gjë të tillë aplikon Serbia për shqiptarët e Luginës

PRISHTINË, 30 JANAR - Sot (e hënë) Kosovën do ta vizitojnë dy personalitete të larta ndërkombëtare: Gabriel Eskobar, i dërguar i presidentit Joe Biden për Ballkanin Perëndimor dhe Miroslav Lajçak, Përfaqësues i Posaçëm i BE-së.

Lëvizja për Bashkim thotë se do të shtohet presioni ndërkombëtar mbi Kosovën në lidhje me vazhdimin e dialogut, e sidomos për implementimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Qeveria e Kosovës nuk duhet në asnjë mënyrë të jetë refuzuese pasive e

propozimeve të ShBA-së dhe BE-së, as të ketë frikë nga dialogu për arritjen e një marrëveshjeje me Serbinë, por duhet ta ndjekë një politikë aktive në raport me dialogun". Lëvizja për Bashkim thotë se Kosova do të duhej ta pranonte Asociacionin nëse një gjë të tillë e bën edhe Serbia për shqiptarët e Luginës së Preshevës. "Qeveria e Kosovës duhet t'u thotë hapur e pa ekuivokë të dy përfaqësuesve ndërkombëtarë, se Kosova edhe do të mund të pajtohej me një asociacion të serbëve në Kosovë, nëse edhe Serbia aplikon po të njëjtin për

shqiptarët në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë. Madje, me reciprocitet në të drejta, Serbia duhet që shqiptarëve të Kosovës Lindore t'ua sigurojë edhe vendet e garantuara në Parlamentin e Serbisë me kompetencat që ua ka siguruar Kosova serbëve të Kosovës".

LB thotë se me propozimin për reciprocitet presioni do të kalonte nga ana e Serbisë. "Në këtë mënyrë Serbia ose duhet ta refuzojë këtë kërkesë të drejtë e legjitime të Kosovës, pastaj ajo do të përballej me presion ndërkombëtar, ose duhet ta pranojë një



reciprocitet të tillë, me çka do të krijoheshin bazat për një marrëveshje gjithëpërfshirëse e të drejtë në mes të Kosovës dhe Serbisë. Përndryshe,

dialogu Kosovë - Serbi është i pakuptimtë dhe nuk sjell asnjë rezultat", thuhet në njoftimin e lëshuar nga Lëvizja për Bashkim.





PARALAJMËROHEN PROTESTA TË REJA KUNDËR SHTRËNJTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

# Kërkohet reflektim nga ZRrE-ja

Subjektet e ndryshme politike dhe shumë qytetarë i kanë kërkuar Zyrës së Rregullatorit të Energjisë që sot (e hënë) ta refuzojë propozimin për shtrenjtimin e energjisë elektrike. Sipas tyre, ZRrE-ja duhet të reflektojë dhe t'i marrë parasysh vërejtjet e shumta të opinionit publik për vendosjen e tarifave. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë janë paralajmëruar protesta dhe aksione të reja për ta kundërshtuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË 30 JANAR** - Pas diskutimit publik, sot (e hënë) Zyra e Rregullatorit të Energjisë pritet të vendosë për propozimin e saj për shtrenjtim të energjisë elektrike. Nëse ky institucion vendos për aplikimin e bllok tarifave, partitë politike kanë paralajmëruar protesta të reja. Një ditë pas protestës së parë, kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Molliqaj, ka kërkuar të dëgjohet vullneti i qytetarëve dhe të kthehet mbrapa propozimi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) për rritje të çmimit të rrymës. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se ngritja e çmimit të energjisë

elektrike është e papranueshme. "Të dëgjohet vullneti i qytetarëve, të kthehet mbrapsht propozimi për shtrenjtim të rrymës. Pabarazia socio-ekonomike në Kosovë është shumë e thellë. Çmimet, përfshirë edhe ato të produkteve bazike ushqimore e higjienike, janë rritur shumë tashmë. Familjet që i përkasin shtresës së varfër dhe asaj të ulët me vështirësi ia dalin në fund të muajit. Në këtë situatë propozimi për shtrenjtim të energjisë elektrike është absolutisht i papranueshëm dhe në kundërshtim të plotë me nevojat e qytetarëve të Kosovës", ka shkruar ai, duke paralajmëruar aksione të reja për t'i kundërshtuar tarifën. "Ky propozim, i cili është në

diskutim publik deri nesër, u kundërshtua fuqishëm nga qytetarët e vendit. Prandaj, kërkojmë nga ZRrE që nesër të mos e aprovojë propozimin në fjalë e ta dëgjojë zërin e qytetarëve. Në të kundërtën, aksionet e protestat do të vazhdojnë derisa ky vendim të kthehet prapa", ka shkruar ai. Edhe Lëvizja për Bashkim ka kërkuar nga ZRrE-ja që të mos vendosë për shtrenjtim të rrymës. "Kosova po përballet me një krizë energjetike si pasojë e krizës në nivel global. Përkundër krizës globale energjetike, gabimet e qeverive të kaluara (mosndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese) si dhe indolencën dhe sjellja e papërgjegjshme e qeverisë aktuale përballet

përkundër paralajmërimeve për krizën energjetike, e bëjnë këtë krizë edhe më të rëndë. Si zgjidhje të krizës energjetike, ZRrE-ja ka propozuar rritjen e ndjeshme të çmimeve të energjisë elektrike, rritje që, edhe pas subvencionimit të premtuar qeveritar, godet më së rëndi një kategori të caktuar konsumatorësh familjarë, përkatësisht ata që shpenzojnë më shumë se 600 KW/h, të cilëve u kërkohet ta bartin gjithë barrën e importit të energjisë elektrike, të dhjetëfishuar si pasojë e krizës globale", ka bërë me dije LB-ja në një njoftim për medie.

Kjo rritje e përnjëhershme e çmimeve të energjisë elektrike, sipas kësaj partie, rrezikon që ta shndërrojë krizën energjetike edhe në një krizë socio-ekonomike. "Andaj, ZrRE-ja do të duhej të reflektonte dhe t'i merrte parasysh vërejtjet e shumta të opinionit publik ndaj propozimeve të tyre, për ta shpërndarë në mënyrë më të drejtë barrën e rritjes së çmimit të energjisë elektrike. Në anën tjetër, Qeveria e Kosovës, në

vend se ta pranonte pjesën e vet të fajit dhe ta merrte përsipër të gjithë barrën e shtrenjtimit të energjisë elektrike (pra, një subvencion njëvjeçar prej 132.7 milionë eurosh) dhe kriza në vitin e parë të mos rëndonte mbi qytetarët, ajo ka zgjedhur që t'i injorojë kërkesat e qytetarëve, madje edhe duke i fyer ata me deklarata skandaloze, si: 'rryma ka qenë e lirë', ose: 'qytetarët as që e kanë ditur se sa ka qenë fatura e energjisë', ka vlerësuar kjo parti.

LB-ja i ka kërkuar qeverisë që të merret edhe me mospagimin e energjisë nga serbet në veri. "Qeveria duhet ta marrë guximshëm përgjegjësinë që ta zgjidhë edhe problemin me konsumatorët në veri të cilët nuk e paguajnë energjinë elektrike, megjithëse furnizohen pandërprerë me energji të prodhuar apo të importuar nga operatorët e Kosovës. Jo pak probleme po i shkaktohen sistemit elektroenergjetik nga dërgimi i energjisë në veri në një regjion të tërë, ku nga shpenzimi i rrymës nuk paguhet

# Escobari dhe Lajçaku vijnë sot në Kosovë, priten mesazhe të qarta rreth dialogut

PRISHTINË, 30 JANAR - Sot (e hënë) do të mbërrijë në Kosovë i dërguari i posaçëm amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhe përfaqësuesi i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak.

Mesazhet kryesore të tyre për institucionet në vend pritet të jenë rifillimi i dialogut dhe zbatimi i marrëveshjeve të kaluara me Serbinë, përfshirë Asociacionin. Madje, sipas njohësve të procesit të dialogut, liderëve institucionalë do t'i parashtrihen edhe kërkesat e sekretarit amerikan Blinken për gjetjen e zgjidhjes për të pagjeturit dhe marrëveshjen për energjinë në veri.

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Dritëro Arifi,

thotë për "KosovaPress" se pret që Lajçaku dhe Escobari t'i kenë kërkesat e unifikuara sa i përket palës së Kosovës. Ai thotë se të njëjtit do të kërkojnë përshtetje të dialogut në tema të caktuara. "Besoj se Lajçaku dhe Escobari do t'i kenë të unifikuara kërkesat sa i përket palës kosovare. ShBA-ja po mundohet në një mënyrë ta riformatizojë dialogun, përshtetuar me tema të caktuara. Ndoshta për t'i dhënë edhe një kornizë me afate, pasi nuk mund të shkojë në dialog për dhjetë vjet dhe të flitet për tema të njëjta. Po besoj se kërkesat do të ndërliken edhe me kërkesën e sekretarit Blinken sa i përket marrëveshjes për energjinë në veri të Kosovës, të pagjeturit dhe normalisht për të

gjitha vendimet e gjykatave që duhet të zbatohen nga institucionet e Kosovës", thotë ai.

Presion më të madh tek Escobari dhe Lajçaku për themelimin e Asociacionit po pret analisti politik Arton Demhasaj. "Mesazhet do të jenë të qarta. Ato [palët] do të shohin se cili është qëllimi politik në Kosovë për këto mesazhe. Pastaj do të priten edhe zgjedhjet në Serbi që do të mbahen në fillim të prillit, sapo të krijohen institucionet e reja në Serbi. Me gjasë shumë shpejt mund të ketë takime që do të mbahen me pretendimin që marrëveshja mund të afrohet... Mesazhet do të jepen ndoshta edhe në mënyrë të shkruar para kryeministrit Kurti, që duhet

urgjentisht të rikthehet në tavolinën e dialogut me pretendimin që shumë shpejt të arrihet marrëveshja finale mes Kosovës dhe Serbisë, e cila do të përfundonte me njohje reciproke... Me gjasë presioni i Lajçakut dhe Escobarit do të lidhet me çështjen krijimit të Asociacionit, pastaj të ketë një marrëveshje përmbyllëse që do të përfundonte me njohje reciproke", thotë ai.

Megjithatë, pavarësisht prej vizitës treditore të ndërmjetësuesve të dialogut, Dritëro Arifi thotë se nuk do të ketë dinamikë të madhe të dialogut para zgjedhjeve në Serbi. "Nuk mendoj se mund të përshtetjohet (dinamikën e dialogut) të paktën para prillit. Edhe nëse mund të ketë ndonjë

takim mund të jetë sa për t'i qetësuar palët. Në një mënyrë për të përcjellë një fotografi se palët kanë gjetur mirëkuptim. Do të jetë më shumë një takim sa për të treguar një paqe mes dy kombeve. Besoj se takimet më të nxehta do të bëhen pas përfundimit të zgjedhjeve në Serbi", shton ai.

Nga 31 janari deri më 2 shkurt Escobari dhe Lajçaku do të takohen me lidhshpinin politik në Kosovë, liderë të partive politike si dhe me përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare. Qëllimi kryesor i vizitës është diskutimi i hapave të ardhshëm në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga BE-ja dhe i mbështetur nga ShBA-ja.



asnjë cent", ka vlerësuar LV, duke shtuar se institucionet e Kosovës duhet ta shqyrtojnë mundësinë e rritjes së kapaciteteve për prodhimin e energjisë. "Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me të gjithë aktorët e tjerë politikë, me ekspertët e fushës dhe me shoqërinë civile, por edhe me partnerët ndërkombëtarë, duhet të fillojë një diskutim serioz për politikën që do të shpinin në ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike të Kosovës, duke

përfshirë edhe kapacitetet me thëngjill e me gaz natyror për mbulimin e nevojave të vendit, duke pasur në konsideratë se situata të ngjashme të krizave do të mund të përsëriten herë pas here. Këto kapacitete duhet të ndërtohen në pajtim të plotë me normat e BE-së për mjedisin dhe, për aq sa është e mundur, pa rrezikuar sigurinë e furnizimit të kontribuojmë në uljen e emetimit të dyoksidit të karbonit", është thënë në njoftimin e LB-së.

## Mijëra qytetarë kundërshtuan rritjen e çmimit të energjisë elektrike

Të shtunën mijëra qytetarë kanë kundërshtuar shtrenjtimin e energjisë elektrike në protestën e organizuar nga Partia Socialdemokrate (PSD). Me moton "Ju e rrisni çmimin, ne rezistencën", qytetarët kanë shprehur pakënaqësitë e tyre ndaj propozimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRë)

për tarifën e reja të energjisë. Protesta kishte filluar nga sheshi Zahir Pajaziti dhe kishte përfunduar para objektit të Qeverisë së Kosovës, ku për disa minuta aktivistët e PSD-së dhe policia ishin shtyrë për vendin e mbajtjes së fjalimeve. Udhëheqësit e kësaj partie para protestuesve kanë përmendur argumentet kundër shtrenjtimit të rrymës, ndërsa aktivistët në shenjë pakënaqësie, në drejtim të objektit të qeverisë, kanë hedhur qirin dhe poçe elektrike.

Këtë protestë e kanë përkrahur edhe partitë e tjera opozitare, por nuk kanë marrë pjesë.

Ditë me parë edhe një pjesë e shoqërisë civile ka organizuar një protestë, ku ka kërkuar që energjia elektrike të mos shtrenjtohet asnjë cent.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) ka propozuar rritje të çmimeve të energjisë për amvisëritë, por jo për bizneset. Qeveria ka thënë se ka ndarë 75 milionë euro që të subvencionojë një pjesë të faturave të energjisë.



## Përkujtohen dëshmorët Hysni Mazreku dhe Ali Kryeziu në Malishevë

**MALISHEVË, 30 JANAR** - Nën përkujdesjen e kryetarit të komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, në 32-vjetorin e rënies, janë përkujtuar dëshmorët e kombit Hysni Mazreku dhe Ali Kryeziu, të cilët ranë më 30 dhjetor të vitit 1990 në qendër të Malishevës gjatë protestave të atij viti kundër regjimit. Në këtë përkujtim kryetari i Malishevës, Ekrem Kastrati, këtë ngjarje e ka vlerësuar si “një ngjarje e kthesave të mëdha historike, pasi për herë të parë në vendin tonë në mënyrë institucionale u reagu ndaj dhunës, vrasjeve dhe genocidit që ushtrohej ndaj shqiptarëve”. “Kjo është datë e

rëndësishme për komunën tonë dhe më gjerë, pasi sot 32 vjet më parë, gjatë protestave ranë dëshmorë Hysni Mazreku dhe Ali Kryeziu. Nga rënia e tyre, Malisheva e ka bartur flakadanin e aktivizimit patriotik si në institucione, ashtu edhe jashtë tyre”, ka thënë kryetari Kastrati, duke shtuar se kjo ngjarje ka shënuar edhe rezistencën e fortë institucionale, pasi komuna e Malishevës si institucion dhe deputetët tanë në Kuvendin e Kosovës bënë rezistencë të fortë lidhur me këtë vrasje dhe vrasjet e tjera. Ai ka përmendur me emra protagonistët e asaj kohe, Daut Krasniqi, kryetar i

komunës, pastaj deputetët Xhemajli Bajra, Halit Kryeziu, Selim Krasniqi dhe të tjerët, që me forcë kundërshtuan dhe reagan ndaj situatës. “Ne që merremi me shtetndërtim duhet ta kemi parasysh sakrificën dhe kontributin e dëshmorëve të kombit dhe të gjithë atyre që luftuan për lirinë që ne sot e gëzojmë”, ka thënë kryetari Kastrati.


Në 32-vjetorin e rënies së dëshmorëve Ali Kryeziu dhe Hysni Mazreku janë bërë nderime dhe homazhe në vendin e rënies, në “Sheshin e Dëshmorëve” në Malishevë, më pas në varrezat në Malishevë dhe Bubavec.



## Antidroga e Policisë zbulon mbi 10 kilogramë drogë të fshehur në një bunker

**PRIZREN, 30 JANAR** - Antidroga e Policisë së Kosovës ka zbuluar mbi 10 kilogramë drogë të fshehur në një bunker në një lokal në Prizren. Lidhur me këtë rast është arrestuar një person i dyshuar. Sipas policisë, ai është recidivist i veprave penale.

Siç njofton policia, zbulimi i drogës ka ardhur pasi Drejtoria për Hetimin e Trafikut të Narkotikëve - Njësia në Prizren, pas një pune operativ-hetimore, dje, në konsultim me prokurorin, ka ndërmarrë veprime në terren në asistim të një patrulle policore dhe është



ndaluar automjeti “Citroën C3”, ngjyrë hiri, që vozitej nga

një person i dyshuar mashkull. Gjatë kontrollit në automjetin

e tij është gjetur një qese plastike e mbushur me substancë të dyshuar të llojit marijuanë. “Menjëherë janë njoftuar autoritetet kompetente të drejtësisë dhe janë marrë autorizime përkatëse për bastisje/kontroll në lokalin dhe shtëpinë e të dyshuarit në Prizren”, ka njoftuar policia.

Në asistim të operatorëve të Njësisë për Reagim të Shpejtë (NJRSh) dhe Forenzikës Rajonale të Prizrenit ka filluar kontrolli në lokalin e të dyshuarit në Prizren. “Gjatë kontrollit, në lokal, nën shkallët e tij, është gjetur një

bunker i kamufluar (modifikuar) mirë, ku vërehej një derë e vogël që në prizëm (të rrymës elektrike) kishte vendin për çelës. Me anë të çelësit që e kishte i dyshuari është hapur ajo derë dhe brenda saj janë gjetur dhe sekuestruar tetë qese plastike me substancë të dyshuar narkotike të llojit marijuanë. Përveç lokalit në fjalë është kontrolluar edhe shtëpia e të dyshuarit ku, po ashtu, është gjetur një qese e vogël me substancë të dyshuar narkotike e dyshuar si marijuanë”, ka njoftuar policia.

## 12 vjet nga vdekja e Fadil Feratit, Abdixhiku: Jeta dhe vepra e tij janë të lidhura ngushtë me fatin e Kosovës për liri e pavarësi

**ISTOG, 30 JANAR** - Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka përkujtuar veprimtarin dhe ish-kryetarin e Istogut, Fadil Ferati, në 12-vjetorin e ndarjes nga jeta. “Janari Lidhjes Demokratike të Kosovës i mori shumë personalitete të rëndësishme, ndër ta edhe Fadil Feratin, nënkryetarin e LDK-së e kryetarin shumëvjeçar të komunës së Istogut. Sot, në 12-vjetorin e ndarjes nga jeta të Fadil Feratit, nderojmë me

respekt dhe mirënjohje të thellë kujtimin, sakrificën dhe trimërinë e tij”, ka thënë Abdixhiku.

Ai ka shtuar se Fadil Ferati i takon plejadës së intelektualëve dhe veprimtarëve të shquar të çështjes kombëtare që nuk u ndalën së punuari për të mirën e vendit deri në frymën e fundit. “Ai ishte një nga themeluesit e degës së LDK-së në Istog. Jeta dhe vepra e tij janë të lidhura ngushtë me fatin e

Kosovës për liri e pavarësi; angazhimi i tij shoqëror e politik ishte misioni dhe vizioni i tij për qeverisje të mirë, dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve; kryetar besnik për të gjithë istogasin. Trashëgimia e vyer intelektuale dhe politike e tij mbeten shembuj frymëzimi për shumë breza për t’i shërbyer me përkushtim, dinjitet dhe krenari vendit”, tha Abdixhiku. Ai ka shtuar se kujtimi për Fadil Feratin është i përgjeshëm.



## Shkolla “Sadri Misini” në Kamenicë nis mësimin online



Kamenicë, 30 janar - Shkolla Fillore e Mesme e Ulët “Sadri Misini”, paralelja e ndarë në Shipashnicë të Poshtme, do të kalojë në zhvillimin e mësimin në formën online për shkak

të numrit të madh të nxënësve dhe personelit arsimor të infektuar me Covid-19. Sipas njoftimit të komunës, këto masa janë marrë duke u bazuar në rekomandimin e

IKShPK-së, si dhe në harmoni me udhëzuesin për organizimin e procesit mësimor në kushtet e pandemisë, i hartuar nga MASHT-i, duke aplikuar skenarin C për mësimin online.



# As miliardat nuk e largojnë varësinë nga thëngjilli



**PRISHTINË, 30 JANAR** - Kosova e ka të vështirë të heqë dorë nga thëngjilli edhe nëse do të përfitonte miliarda euro, thonë njohës të fushës së energjisë.

Mbi 90 për qind e energjisë elektrike në Kosovë prodhohet nga mihja e thëngjillit dhe nxjerrja e linjtit, ndërsa pjesa tjetër nga burime të ripërtërishme, të tilla si: hidrocentralet, centralet me erë dhe panelet diellore.

Në një raport të publikuar nga organizatat evropiane të mjedisit "The Green Tank" dhe "Bankwatch Network", të titulluar "Fondi i tranzicionit të drejtë për vendet e Ballkanit Perëndimor", thuhet se Kosova mund të përfitojë mbi katër miliardë euro nga fondet e Bashkimit Evropian nëse angazhohet për heqjen dorë nga thëngjilli. Si afat në raport përmendet viti 2030.

Kosova, me anë të nënshkrimit të Marrëveshjes së Samitit të Sofjes, dy vjet më parë është zotuar se deri në vitin 2050 do të dekarbonizohet apo do ta zvogëlojë varësinë nga thëngjilli. Thëngjilli - burim i energjisë që nuk rigjenerohet - prodhon ndotje toksike kur digjet.

Synim i BE-së është që ta shkurtojë në maksimum ndotjen nga termocentralet prej thëngjillit, e cila ndikon

negativisht edhe në ngrohjen globale.

Ministria e Ekonomisë e Kosovës ka bërë me dije se është duke hartuar Strategjinë e Energjisë për periudhën 2022-2031. Në një postim në "Facebook", ditë më parë, ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se objektivat kryesore të Strategjisë së Energjisë janë "rritja e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji, përballueshmëria financiare për konsumatorët, si dhe rruga drejt procesit të dekarbonizimit", por ajo nuk ka dhënë detaje se si do të realizohen këto.

Rinora Gojani, nga organizata rajonale "Balkan Green Foundation", e cila promovon përparimin gjithëpërfshirës në Ballkanin Perëndimor, thotë se tranzicioni energjetik është proces teknologjik që kërkon financa, kohë, ekspertizë dhe, mbi të gjitha, ambient të mirë të investimit. "Se a mjaftojnë 4 miliardë euro për ta realizuar tranzicionin energjetik të Kosovës është çështje e diskutueshme për shkak të mungesës së një plani të fizibilitetit, porse pa dyshim që kjo do të ndikonte jashtëzakonisht shumë në dekarbonizimin e sektorit të vendit", thotë Gojani për "Radion Evropa e Lirë". Sipas saj,

ky tranzicion energjetik nuk mund të jetë i suksesshëm pa ndërlikime me shtetet e tjera dhe pa shkëmbime të energjisë ndërmjet shteteve dhe rajoneve. "Me rëndësi është që, përpos ndryshimit të sistemit të nxitjes së burimeve të ripërtërishme të energjisë, të përshejtohet puna e blerjes së energjisë nëpërmjet sistemit të ankandëve, të nxiten vetëprodhuesit, sidomos ata me panele solare", thotë Gojani. Në një deklaratë të mëhershme për "Radion Evropa e Lirë", zëvendësministrja e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Kosovë, Linda Çavdarbasha, ka thënë se procesi i tranzicionit në energji të burimeve të ripërtërishme në Kosovë kërkon kohë më të gjatë se në shtetet e rajonit. "Po besoj se Kosovës i duhet kohë më e gjatë për ta bërë këtë lloj tranzicioni, mirëpo nuk është e pamundshme. Kështu që, energjia e erës dhe energjia solare janë dy burimet e energjisë të cilat kanë potencial për t'u zhvilluar në Kosovë", ka thënë Çavdarbasha.

## Çeku: Thëngjilli s'ka alternativë

Ish-ministri i Energjisë i Kosovës, Ethem Çeku, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se

Kosova nuk mund të heqë dorë nga thëngjilli sepse nuk ka burime të tjera. "Sot gjysmën e Gjermanisë e kemi me thëngjill, Amerika një të tretën e produkteve i ka me thëngjill. Ato [termocentralet me thëngjill], në një kohë, do të mbyllen, por [këto vende] kanë burime të tjera, si hidrike, energji atomike... kanë dhjetëra alternativa të tjera. Te ne, cila është alternativa që e zëvendëson thëngjillin?", pyet Çeku.

Edhe Arben Gjukaj, ish-drejtor i Korporatës Energjetike të Kosovës, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se Kosova është larg plotësimit të kërkesave me anë të burimeve të ripërtërishme. Ai thotë se fondet e BE-së do të mundësonin një "tranzicion më të butë" në burime të ripërtërishme por, sipas tij, Kosova e ka më të vështirë sesa vendet e tjera, sepse edhe varësinë nga thëngjilli e ka më të madhe. "Ne varemi 95 për qind nga burimet e energjisë nga thëngjilli, andaj kërkohet mobilizim i konsiderueshëm i burimeve financiare", thotë Gjukaj.

Sipas raportit të organizatave "The Green Tank" dhe "Bankwatch Network", Kosova prin në rajon sa i përket

përdorimit të thëngjillit për prodhim të energjisë elektrike - me 95 për qind. Ajo pasohet nga Serbia me 68 për qind, Bosnjë e Hercegovina me 63 për qind, Maqedonia e Veriut me 60 për qind dhe Mali i Zi me 44 për qind.

Termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B", që ndodhen në qytetin e Obiliqit, janë burimet kryesore të rrymës me anë të djegies së thëngjillit, ndonëse nuk i plotësojnë nevojat e shtetit, kryesisht për shkak të vjetërsisë.

Sipas të dhënave të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në Kosovë (ZRRE), Kosova e ka nisur vitin 2022 me nivel të ulët të gjenerimit të rrymës: nga 500 deri në 800 megavatë në orë.

Kërkesat, ndërkaq, ndryshojnë varësisht ditës apo javës.

Për shembull, më 19 janar kapacitetet vendore të prodhimit kanë qenë 727 megavatë, kurse konsumi ka arritur deri në 1 317 megavatë. Për plotësimin e nevojave, Kosova importon rrymë.

BE-ja ka vënë një objektiv të detyrueshëm që deri në vitin 2030 energjia e prodhuar nga burimet e ripërtërishme të jetë 32 për qind. Ky rregull duhet të respektohet edhe nga Kosova, e cila synon që një ditë të bëhet anëtare e BE-së.



# Ç'ndodhi në grabitjen me vlerë 113 milionë euro që shokoi botën

U deshën të paktën nëntë goditje të forta me sëpatë për të thyer kutinë e xhamit në kasafortën historike të muzeut Green Vault në Dresden, Gjermani, i cili përmban koleksionin më të madh të thesarit në Europë. Pasi xhami u thye, dy hajdutët e maskuar rrëmbyen 21 objekte të çmuara të mbushura me diamante dhe u zhdukën.

Ngjarja ndodhi më 25 nëntor 2019 dhe për pak minuta, disa nga xhevahiret më të vlefshme historike në botë ishin zhdukur. Një gjyq për gjashtë burrat e akuzuar për kryerjen e një prej vjedhjeve më të mëdha të bizhuterive në histori nisi në Gjermani këtë të premte, më 28 janar. Por misteri i asaj që ndodhi me thesaret e vjedhur vazhdon ende.

Të stolitur me më shumë se 4,300 diamante, thesaret e vjedhura nga Green Vault kanë

këllëf të cilat së bashku përmbanin më shumë se 800 diamante.

Përveç vlerës së sendeve, mënyra si u krye grabitja tërhoqi vëmendjen botërore. Roy Ramm, një konsulent sigurie dhe ish-komandant i operacioneve të specializuara në New Scotland Yard në Londër, tha për CNN se krimet si ky janë gjithnjë e më të rralla.

"Siguria teknike është përmirësuar me kalimin e viteve me sistemet e alarmit CCTV dhe të gjitha llojet e mbrojtjeve të teknologjisë së lartë, kështu që [ekziston një rrezik i lartë] për zbulim të hershëm dhe për t'u kapur në flagrancë. Kështu që duhen disa informacione të brendshme dhe shumë, plan shumë i detajuar," tha ai.

Sipas hetuesve, katër muaj para grabitjes, një i dyshuar shkoi në qytetin e Magdeburgut për të



për CNN.

"Nëse makina shihej nga një kalimtar i rastësishëm që po largohej nga vendi i ngjarjes dhe ai person ishte në gjendje të jepte një përshkrim të makinës, sapo policia të fillonte të bënte hetime për atë automjet, hetimet do të bëheshin më të komplikuar, më të vështira dhe do të kërkonin më shumë kohë për t'u zgjidhur."

Por ata nuk u ndalën vetëm te makina e arratisjes. Disa ditë para grabitjes, sipas autoriteteve, hekurat e dritareve ku hajdutët hynë në kasafortë u prenë. Heqja plotësisht e grilës metalike mund të ketë ngritur dyshimin e kalimtarëve, kështu që të dyshuarit mbuluan gjurmët duke i ngjitur përkohësisht hekurat me ngjitës.

Dritarja nuk ishte e dukshme në kamerat e sigurisë dhe e gjithë zona ishte në "errësirë ??të plotë", tha Ministria e Kulturës dhe Turizmit. Një sensor lëvizjeje që duhej të ishte shkaktuar nga vjedhja nuk dha sinjal. Ministria tha se alarmi ishte prishur një ditë para krimin dhe rojet e sigurisë nuk arritën ta riaktivizojnë.

Policia tha se hajdutët ose bashkëpunëtorët e tyre i vunë zjarrin një pike të shpërndarjes së energjisë pranë Green Vault. Kjo bëri që dritat e rrugëve aty pranë të fiken, duke e zhytur të gjithë zonën në errësirë. Policia theksoi se videoja e kamerës së sigurisë tregonte që ata e dinin se ku po shkonin.

Pamjet e kamerave të sigurisë treguan se grabitësve iu deshën vetëm disa minuta për të hyrë brenda, për të thyer vitrinën, për të marrë bizhuteritë dhe për t'u larguar. Ata nuk mundën të vidhnin të gjitha pjesët, sepse disa ishin të qepura në kuti.

Para se të arratiseshin, grabitësit spërkatën dhomën me një pluhur për të mbuluar gjurmët e këmbëve që përdoren shpesh për të kapur kriminelët. Audi u gjet në një garazh nëntokësor disa kilometra larg, plotësisht i djegur. Djegia e

presionit përreth vendit. Është jashtëzakonisht e rrezikshme të bësh atë që ata bënë."

Zyra e Prokurorit të Shtetit tha në mars 2020 se po hetonte katër njerëz të personit të sigurisë. Asokohe u tha se dy roje janë hetuar. Njëri dyshohej se u kishte dorëzuar autorëve dokumente në lidhje me Green Vault dhe sistemet e sigurisë dhe u arrestua katër ditë pas grabitjes. Tjetri u lirua pas një hetimi. Një roje tjetër po hetohet pasi ka prova për një veprim në lidhje me sistemin e alarmit, i cili mund të ketë lehtësuar vjedhjen.

Policia dyshonte te pesë anëtarë të klanit famëkeq Remmo, një nga grupet më të fuqishme të krimin në Gjermani, e cila vepron kryesisht në Berlin. Policia i identifikoi dy të dyshuarit si vëllezërit binjakë Abdul Majed R. dhe Mohamed R. Interpoli ndërhyri dhe pas disa kohësh kërkim, njëri prej binjakëve u kap në Berlin, një zonë e kontrolluar nga Remmo. Tjetri u kap më vonë, në maj 2021.

Pra, çfarë ndodhi me bizhuteritë e çmuara? Ekspertët besojnë se skenari më i mundshëm është ai që kuratorët e muzeut kishin frikë: sendet e vjedhura janë thyer,



vlerë të paktën 113 milionë euro sipas autoriteteve. Megjithatë, drejtori i Koleksionit Shtetëror të Arteve të Dresdenit, Marion Ackermann, tha se vlera e tyre materiale as që krahasohet me rëndësinë historike dhe kulturore.

Pothuajse të gjitha artefaktet e vjedhura u bënë gjatë sundimit të Frederick Augustus III, Zgjedhësi i fundit i Saksonisë, i cili më vonë u njoh si Frederick Augustus I, mbreti i parë i Saksonisë. Disa nga thesaret e vjedhura janë: një kapëse e viteve 1780 e zbukuruar me 15 diamante të mëdhenj dhe më shumë se 100 të vegjël, si edhe një shpatë 96 centimetra me

marrë një Audi S6 të përdorur në ngjyrën blu të errët: makinën e ardhshme të arratisjes. Automjeti ishte çregjistruar, por policia tha se banda shkoj edhe më tej në përpjekjet për të maskuar origjinën, duke ndryshuar ngjyrën e makinës në argjend dhe duke lënë vetëm çatinë e errët.

"Ajo që kuptoj është se këta njerëz kishin planifikuar me përpikëri gjithçka; ata e dinin në mendjen e tyre se si do të ndodhte grabitja dhe cili do të ishte reagimi i policisë dhe gjatë gjithë kohës mendonin për mënyra për të humbur gjurmët ose për t'i dhënë vetes më shumë kohë," tha Ramm



"Duhet të dini se nuk ka, për shembull, rreze lazer nëpër dhomë, duhet të dini se nuk ka sensorë të ndjeshëm ndaj

gurët janë shitur dhe metalet e çmuara janë shkrirë.

"E gjithë kjo kërkon organizim," tha konsulenti i sigurisë, Roy Ramm. "Është shumë e rrallë që njerëzit që kanë vjedhur sendet të jenë njerëzit që i kanë asgjësuar ato. Do të ketë një rrjet."

Hard disqe, kompjuterë dhe telefona celularë u sekuestruan gjatë hetimit të madh policor, por vetë thesaret e vjedhura janë zhdukur pa lënë gjurmë.

Green Vault qëndroi i mbyllur për vizitorët për muaj të tërë, për shkak të hetimit dhe më vonë pandemisë. Kur u rihap në maj 2020, kabineti i vjedhur u riparua, por u la qëllimisht bosh. Gjyqi është planifikuar të zgjasë të paktën deri në fund të tetorit. Nëse shpallen fajtorë, të dyshuarit do të përballen me dënime me disa vite burg.





# Këshilltari i Peresit dhe Carterit që u shpëtua nga shqiptarët gjatë Holokaustit



Profesori dhe konsulenti i menaxhimit i lindur në Serbi, hebreu Ichak Kalderon Adizes, është zotuar t'i nderojë dy vëllezër shqiptarë me titullin "Të drejtët mes kombeve", për shpëtimin e tij dhe të familjes së tij gjatë Holokaustit, raporton "Jewish News", transmeton Telegrafi. Në kujtimet e tij, "The Accordion Player" (Harmonisti), Adizes tregon se si gjyshja dhe prindërit e tij janë fshehur për afro dy vjet nga vëllezërit Ali dhe Raxhib Brahimi, në një fshat të largët shqiptar. Familja u paraqit si myslimane, pasi një kadi lokal ose një hoxhë i sollti në fshat. Për pak kohë, më herët, ata kishin qëndruar në kampin e Monopolit në Shkup. Për shumë vjet Adizes besonte se vëllezërit e askush tjetër në fshat nuk e dinin se kjo familje ishte hebraike. Natyrisht, prindërit e tij e ruanin këtë pretendim duke u thënë mbrojtësve se janë "myslimanë boshnjakë" e se kanë tradita të ndryshme lutjeje nga ta. Gjatë muajit të Ramazanit, babai i Adizesit – shtatëvjeçar atë kohë – e detyronte atë të ngjitej lart në shtëpinë ku jetonin, në mënyrë që familja

e tij të mund të hante. Nëse dëgjonte ndonjë lëvizje nga vëllezërit Brahimi, duhej të hidhej lart e poshtë për të paralajmëruar prindërit. Dihet se besimtarët që e praktikojnë islamin nuk hanë gjatë Ramazanit, pos në iftar ose syfy. Sidoqoftë, në vitin 1996, një televizion izraelit e dërgoi Adizeun dhe babanë e tij në Shqipëri për të ndjekur gjurmët e fshehjes dhe ikjes, dhe, për mrekulli, takohen me vëllezërit Brahimi dhe kushërinjtë e tyre. Gjatë xhirimeve të dokumentarit "Unë dua të kujtoj, ai dëshiron të harrojë", u bë e qartë se askush në fshat nuk e kishte besuar asnjë prej historive të Adizesëve për veten e tyre. Babai i Adizesit, Salamon (Moni) Adizes, ishte personazh i shkëlqyeshëm që kishte vepruar si mjek gjatë kohës së qëndrimit në fshat. Metoda e tij standarde e trajtimit ishte të përshkruante një kohë që duhet kaluar në ajër të pastër dhe me diell megjithëse, herë pas here – siç shkruan Adizes në kujtimet e tij – bënte operacione të vogla dhe ndihmonte në lindjen e fëmijëve.

Por, gjatë xhirimeve të dokumentarit, vëllezërit Brahimi deklaruan se e kishin ditur gjatë gjithë kohës se janë hebrej, siç e dinte kadiu apo hoxha që i kishte dërguar në fshat. Ata gjithashtu e dinin se Moni nuk ishte mjek – në jetën reale ishte disleksik dhe pothuajse analfabet – por e lejuan të vazhdonte me pretendimin e tij. Pas luftës familja u zhvendos në Izrael, ku Ichaku ishte në Forcat Mbrojtëse. Moni nisi të punojë në portin e Haifës. Ichaku kishte mësuar të luante në harmonikë dhe i "armatosur" me këtë instrument – dhe me 50 dollarë në xhep – u largua nga Izraeli për në Amerikë ku e nisi një karrierë të shkëlqyer në biznes dhe këshillim. Gjatë viteve, prej një fillimi të vështirë u bë këshilltar i kryeministrave dhe presidentëve, përfshirë Shimon Peresin dhe Jimmy Carterin. I shkroi kujtimet e tij gjatë një periudhe prej 15 vjeçare. Thotë se ishte shumë e vështirë për të për të shkruar, por edhe diçka "shumë terapeutike", meqë e kuptoi se babai i tij "ishte figurë tragjike ... nuk dinte të lexonte apo të shkruante dhe

të gjithë e përlunin. I vetmi unë isha ai mbi të cilin kishte autoritet. Kështu që të gjitha zhgënjimet e tij ranë mbi supet e mia. Por, unë e fal atë". "Moni Adizes", thotë djali i tij, "harroi se ishte hebre që fshihej nga nazistët. Teksa për ne kjo ishte koha më e keqe në jetë, për të ishte koha më e mirë sepse për herë të parë ishte dikush që ka rëndësi". Është një numër relativisht i vogël shqiptarësh të nderuar nga "Yad Vashemi", për shpëtimin e hebrejve gjatë Holokaustit. Më 2015 u bë emërimi i fundit të "Të drejtët mes kombeve". Adizes pranon sot se ka "dështuar" në emërimin e vëllezërve Brahimi më 1996, duke thënë se dokumentet e kërkuara e kishin mundur. Por, sot, në moshën 85-vjeçare, thotë se do të provojë përsëri dhe do të shkojë në "Yad Vashem" në prill (ka një shtëpi në Izrael dhe një në Santa Barbara të Kalifornisë) për t'i dhënë dëshmitë përkatëse. Si autor libri (që do të botohet më vonë gjatë këtij viti), Adizes ende luan dhe zotëron tri instrumente, megjithëse insiston se një nga djemtë e tij muzikant luan shumë më mirë se ai. Por, është

harmonika ajo që e mbajti gjallë gjatë viteve të hershme të tij në Shtetet e Bashkuara, duke luajtur në cepat e rrugëve dhe në restorante për ndonjë bakshish, ndërkohë që shkante në universitet. Mesazhi i tij qendror në libër është: "Atë që e synon, ajo do të ndodhë". Buzëqesh teksa thotë se nga babai i tij e ka thënë "kërcej, ndaj i bëj gjërat të ndodhin". Specialisti i Holokaustit dhe gjenocidit, Stephen Smith, ka thënë: "Mbijetesa e familjes Adizes është një nga më të pazakontat që kam dokumentuar. Janë pak të njohura historitë e hebrejve sefardi në Ballkan, të cilët katërqind e pesëdhjetë vjet pas inkuizicionit spanjoll iu nënshtruan Zgjidhjes Përfundimtare naziste. Është frymëzues guximi i familjeve myslimane që u futën në rreziqe të mëdha për jetët e tyre, për t'i dhënë siguri familjes Adizes. 'Yad Vashem' ka standarde të rrepta për ata që njihen si 'Të drejtët mes kombeve'. Shpresoj që familja që i dha strehë familjes Adizes do të njihet për gjithçka që bënë për t'ia dhënë kësaj shansin kësaj familjeje për të mbijetuar dhe për të përparuar".



# Si u bë Facebook-u “opiumi i masave”



## Nga František VRABEL

Në luftën kundër keqinformimit, armiku mund të jetë i vështirë për t'u përcaktuar.

Gazetarët, politikanët, qeveritë, madje edhe gjyshërit janë akuzuar se kanë mundësuar përhapjen e gënjeshtrove në internet.

Ndërsa asnjë nga këto grupe nuk është tërësisht i pafajshëm, kundërshtari i vërtetë është më i zakonshëm. Siç dëshmoi dekonspiruesja e Facebook, Frensis Hogen, në fundin e vitit të kaluar, janë algoritmet e mediave sociale ato që e bëjnë të mundur keqinformimin përmes rrjetit.

Që nga themelimi i tij në vitin 2004, Facebook është rritur nga një faqe e rrjeteve sociale të disa mijëra studentëve, në një “përbindësh vëzhgim” që po e shkatërron kohezionin social dhe demokracinë në mbarë botën.

Facebook mbledh të dhëna të përdoruesve – përfshirë fakte shumë personale, si pesha trupore apo shtatzënia – për të hartuar ADN-në sociale të përdoruesve të tij. Më pas kompania ia shet këtë informacion kujtdo – nga prodhuesit e shampove tek shërbimet sekrete ruse dhe kineze apo kujt do që dëshiron të “mikro-shënjestrojë” 2.9 miliardë përdoruesit e kësaj platforme.

Në këtë mënyrë, Facebook u lejon palëve të treta të manipulojnë mendjet dhe të tregtojnë “të ardhmen njerëzore”: modele parashikuese të zgjedhjeve që mund të bëjnë individët. Facebook është përdorur në

mbarë botën, për të mbjellë mosbesim tek institucionet demokratike.

Algoritmet e tij kanë lehtësuar përdorimin e dhunës në botën reale, nga gjenocidi në Myanmar deri tek rekrutimi i terroristëve në Amerikën e Jugut, Afrikën Perëndimore dhe Lindjen e Mesme. Gënjeshtret për manipulimin e zgjedhjeve në Shtetet e Bashkuara, të promovuara nga ish-presidenti Donald Trump, vërshuan në Facebook përpara trazirave të 6 janarit 2021.

Ndërkohë në Evropë, Facebook bëri të mundur përpjekjet perverse të liderit autokrat të Bjellorusisë, Aleksandër Lukashenko për t'i përdorur emigrantët si armë kundër Bashkimit Evropian. Në Republikën Çeke, keqinformimet me origjinë nga Rusia, dhe të shpërndara në rrjet e kanë pushtuar hapësirën kibernetike çeke, falë kodit keqdashës të Facebook.

Një analizë e bërë nga kompania ime, zbuloi se qytetari i zakonshëm çek është i ekspozuar 25 herë më shumë sesa një amerikan mesatar ndaj keqinformimit në lidhje me vaksinën Covid-19. Situata është aq e rëndë, dhe veprimi i qeverisë kaq i dobët, sa që çekët mbështeten tek shoqëria civile – përfshirë vullnetarët e njohur si “Elfët” çekë – për ta monitoruar dhe kundërshtuar këtë ndikim.

Deri më tani përpjekjet për të reduktuar kërcënimin e Facebook ndaj demokracisë, kanë dështuar. Në Republikën Çeke, Facebook hyri në një partneritet me Agence France-Presse për të identifikuar përmbajtjet e

dëmshme.

Por me vetëm një punonjës me kohë të pjesshme, dhe me një kuotë mujore prej vetëm 10 postimesh të dyshimta, këto përpjekje janë një pikë në “oqeanin” e keqinformimit. “Dosjet e Facebook-ut”, të publikuara nga “The Wall Street Journal”, konfirmojnë se Facebook vepron në vetëm 3-5 për qind të rasteve të gjuhës së urrejtjes.

Facebook u ka dhënë përdoruesve mundësinë që të heqin dorë nga reklamata me porosi dhe ato politike. Por ky është një gjest simbolik. Disa organizata, si “Ranking Digital Rights”, kanë kërkuar që platforma të çaktivizojë opsionin e reklamave të detyrueshme për t'u shfaqur.

Por kjo nuk mjafton. Mikroshënjestrimi që është në bazën e modelit të biznesit të Facebook, mbështetet tek Inteligenca Artificiale për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve, për të maksimizuar angazhimin e tyre, dhe për të çaktivizuar të menduarit kritik.

Në shumë aspekte, mikroshënjestrimi është ekuivalenti dixhital i krizës së opioideve. Por Kongresi Amerikan është treguar shumë aktiv vitet e fundit për të mbrojtur njerëzit nga opioidet përmes një ligji që synon të rrisë qasjen në trajtim, edukim dhe mjekime alternative.

Për t'i dhënë fund varësisë së botës ndaj lajmeve të rreme dhe gënjeshtrove, ligjvënësit duhet të njohin krizën aktuale të keqinformimeve për atë që është, dhe të ndërmarrin veprime të ngjashme, duke filluar me rregullimin e duhur

të modelit të mikroshënjestrimit.

Problemi është se askush jashtë Facebook-ut nuk e di se si funksionojnë algoritmet komplekse të kësaj kompanie. Dhe mund të duhen muaj, në mos vite, për t'i deshifruar ato. Kjo do të thotë se rregullatorët nuk do të kenë zgjidhje tjetër, veçse të varen nga punonjësit e Facebook që t'i orientojnë ata në këtë detyrë. Për të inkurajuar këtë bashkëpunim, Kongresi duhet t'u ofrojë atyre imunitet të përgjithshëm civil dhe penal dhe dëmshpërblim financiar.

Rregullimi i algoritmeve të mediave sociale duket si një proces i ndërlikuar, por kjo nuk është asgjë krahasim me rreziqet dixhitale edhe më të mëdha në horizont. “Deepfakes” – manipulimi në shkallë të gjerë i videove dhe imazheve i bazuar sërish tek Inteligenca Artificiale për të lëkundur opinionin publik – nuk është ende një temë dominuese e diskutimeve në Kongresin Amerikan.

Ndërsa ligjvënësit po shqetësohen për kërcënimet e paraqitura nga përmbajtja tradicionale, “Deepfakes” paraqesin një sfidë edhe më të madhe për privatësinë individuale, demokracinë dhe sigurinë kombëtare. Ndërkohë vetë Facebook po bëhet më i rrezikshëm.

Një investigim i kohëve të fundit nga “MIT Technology Review” zbuloi se kompania financon keqinformimin duke “paguez miliona dollarë reklama për klikuesit me pagesë”. Dhe planet e kreut të saj, Mark Zuckerberg, për të ndërtuar një metaverse, “një konvergencë midis realitetit

fizik, të shtuar dhe atij virtual”, duhet të frikësojnë kudo entet rregullatore. Mjafton të imagjinoni dëmin e mundshëm që mund të shkaktojnë këto algoritme të parregulluara të Inteligjencës Artificiale, në rast se lejohen të krijojnë një realitet të ri për miliarda njerëz.


Në një deklaratë pas seancave të fundit dëgjimore në Uashington, Zuckerberg përsëriti një ofertë që e ka bërë edhe më parë: “Rregulloni me ligj aktivitetin tonë”.

“Unë nuk besoj se kompanitë private duhet që t'i marrin vetë të gjitha vendimet. Ne jemi të përkushtuar të bëjmë punën më të mirë që mundemi. Por në një farë niveli, organi i duhur për të vlerësuar çështjen e respektimit të të drejtave të privatësisë është Kongresi ynë i zgjedhur në mënyrë demokratike” - tha ai.

Zuckerberg ka të drejtë: Kongresi i SHBA-së ka përgjegjësinë të veprojë. Por edhe Facebook ka gjithashtu përgjegjësinë të veprojë. Derisa Facebook të lejojë shqyrtimin e algoritmeve të tij, lufta kundër keqinformimit nuk do të fitohet, dhe demokracinë në mbarë botën do të vazhdojnë të jenë në mëshirën e një industrie të paskrupullt dhe renegate.

Shënim: František Vrabel, shkrimtar dhe themelues i “Semantic Visions”, një kompani analitike me seli në Pragë që mbledh dhe analizon 90 për qind të përmbajtjes së lajmeve në internet në botë. / “Project Syndicate” – Bota.al





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

# Kampionët vazhdojnë me fitore, Trepça triumfon në derbi ndaj Pejës



**PRISHTINË, 30 JANAR** - Golden Eagle Ylli ka vazhduar me fitore, duke mundur Sigal Prishtinën me rezultat 85:79 (26:20, 20:17, 17:22, 22:20), në kuadër të javës së 18-të të Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll. Fillimi i ndeshjes ishte interesant dhe i baraspeshuar, por pranë rezultatit 13:14, vendasit hyn në një seri prej 7:0, duke kaluar në epërsi 20:14, ndërsa çerekun e parë e fituan 26:20. Në periudhën e dytë kundërpërgjigjen mysafirët, duke barazuar shifrat në 35:35, e më pas zhvillohet një lojë e barabartë, kurse në fund të kësaj pjese, therandasi ishin më të mirë, për të shkuar në pushim me shifrat 46:37. Loja ishte interesante edhe në pjesën e dytë. Kryeqytetasit nuk u dorëzuan dhe arritën të afrojnë shifrat në 58:56, duke e bërë ndeshjen shumë interesante, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 63:59. Kjo bëri që në dhjetë minutat e fundit të jetë një sfidë dramatike. Kështu ishte

deri në fund, ku fituesi nuk dihej deri në sekondat e fundit, megjithatë, në fund, vendasit ishin më të vëmendshëm dhe fituan me rezultat 85:79. Te Golden Eagle Ylli u dalluan Henrik Sirko me 29 pikë e pesë kërcime, Aj Sumbry me 19 pikë e tetë kërcime dhe Erjon Kastrati me 20 pikë e gjashtë kërcime, kurse te Sigal Prishtina u dalluan Jan Palokaj me 13 pikë e nëntë kërcime dhe Kenneth Brown me 27 pikë e katër kërcime. Golden Eagle Ylli ka 14 fitore e katër humbje, ndërsa Sigal Prishtina ka nëntë fitore e nëntë humbje. Trepça ka shënuar fitore ndaj Pejës me rezultat 96:81 (17:11, 26:23, 25:23, 28:24), në derbin e xhiros së 18-të të Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll. Vendasit e nisën ndeshjen për mrekulli me një seri prej 12:2, ndërkohë, që mysafirët e ndienin shumë mungesën e Dardan Berishës, Ilter Erdem dhe Stephen Maxwell të lënduar, ndërsa që mitrovicasit e fituan çerekun e parë 17:11.

Mitrovicasit vazhduan me lojë të mirë, duke e thelluar edhe më shumë epërsinë, ku më e larta ishte 20 pikë, 43:23, megjithatë, pejanët arritën të ngushtojnë shifrat në 43:34, sa përfundoi pjesa e parë.

'Xehetarët' e nisën pjesën e dytë më mirë, përkatësisht periodën e tretë, ku sërish shkëputen në 21 pikë, kurse e gjitha çfarë bënë mysafirët ishte ngushtimi i rezultatit, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 68:57. Në dhjetë minutat e fundit, loja u menaxhua nga vendasit që për asnjë moment nuk rrezikuan fitoren, duke triumfuar me rezultat 96:81. Te Trepça u dalluan Amin Hot me 18 pikë, shtatë kërcime e pesë asistime dhe Drilon Hajrizi me 21 pikë, shtatë kërcime e katër asistime, kurse te Peja u dallua Tyrone White me 35 pikë e gjashtë kërcime.

Mitrovicasit kanë 12 fitore e gjashtë humbje, ndërsa pejanët kanë 11 fitore e shtatë humbje.

## SHKURT

### Ekipi Olimpik i Kosovës arrin në Kinë

Pas një udhëtimi 'maratonik' Prishtinë – Stamboll – Pekin, ekipi olimpik i Kosovës ka arritur në Fshatin Olimpik në Yanqing të Kinës. Ekipi i është nënshtruar procedurave për Covid 19 në aeroportin ndërkombëtar të Pekinit dhe në Fshatin Olimpik. Ekipi përbëhet nga skitarët Kiana Kryeziu e Albin Tahiri, trajneri Agim Pupovci dhe shefi i misionit, Bujar Turjaka.

### Nadali fiton 'Australian Open'

Rafael Nadal është shpallur kampion i Grand Slamit Australian Open, duke mposhtur në finale Daniil Medvedev. Rusi pati avantazh prej dy seteve 6:2 dhe 7:6, porse spanjoli nuk u dorëzua, duke fituar krejt ndeshjen më pas, që i bie tre sete rresht; 6:4, 6:4 dhe 7:5. Me titullin arritur në Australi të dielën, Rafael Nadal bëhet tenisti me më së shumti Grand Slam të fituar në historinë e këtij sporti, në total 21 trofe. Ai lë pas vetes zviceranin Roger Federer dhe serbin Novak Djokovic me nga 20 Grand Slam. Nadal ka fituar 2 Australian Open, 13 French Open, 2 Wimbledon dhe 4 US Open. Sa i përket çmimit në Australian Open, Nadal është pasuruar me 2 milionë e 875 mijë dollarë, kurse Medvedev si nënkampion me 1 milion e 575 mijë.

### Erikseni te Brentford për 6 muaj

Christian Eriksen rikthehet në Premier League dhe pritet njoftimi i Brentford për afrimin e mesfushorit të Danimarkës që prishi kontratën me Interin. Në Itali nuk lejohet të luash me defribilator në zemër dhe mesfushori ishte i detyruar të zgjidhte kontratën. Eriksen ka kryer kontrollin mjekësor dhe i ka kaluar ata. Mesfushori tani do të nënshkruajë për 6 muaj me Brentford dhe do të bëhet lojtari i parë në Premier League që luan me defribilator.

### Suedia, kampione e Evropës në hendboll

Suedia ka fituar titullin e kampionit të Evropës në hendboll. Në finalen dramatike të së dielës, Suedia fitoi ndaj Spanjës me rezultat 27:26. Fitoren suedezët e siguruan me golin e shënuar nga penalltia në sekondën e fundit. Për vend të tretë, Danimarka e mposhti Francën. Për Suedinë është titulli i pestë i Evropës, i pari që nga viti 2002. Suedia konfirmohet si Kombëtarja më e mirë evropiane, shkruan FHK-ja. Lojtari më i vlefshëm i Evropianit është shpallur suedezi Jim Gottfridsson. Kosova ishte kundërshtarë e Suedisë në kualifikimet për Evropian. Në Prishtinë kemi luajtur më 8 nëntor të vitit 2020, ndërsa në Alingsas më 2 maj të vitit 2021.

## Ademi: Nuk i kemi pasur opSION trajnerët nga Turqi, Magathi nuk e ka refuzuar Kosovën

**PRISHTINË, 30 JANAR** - Tash e disa ditë, pozita e përzgjedhësit të Kosovës është çështja kryesore, me të cilën është duke punuar Federata e Futbollit të Kosovës. Presidenti i FFK-së, Agim Ademi se bashku me komisionin ka qenë në bisedime me disa trajnerë nga anë e mbanë Evropa, por ende s'kanë arritur

marrëveshje me asnjërin prej tyre. Para disa ditëve është raportuar që FFK është në negociata me një trajner turk, por kjo nuk është e vërtetë. Ademi për "Lajmi.net" ka zbuluar se trajnerët turq nuk janë as opSION për Kosovën. "Asnjëherë turk, pa ndonjë nënçmim, nuk kemi biseduar dhe as nuk i kemi

pasur si opSION, për faktin që kemi listën prej pesë trajnerëve finalistë dhe sigurisht kërkojmë diçka të Evropës. Ekipi dhe lojtarët tanë janë që jetojnë në Evropë kanë kulturën e tyre, prandaj duam trajner të Gjermanisë dhe Zvicrës, sigurisht kërkojmë një kalibër të tillë evropian". Tutje, Ademi mohoi edhe

spekulimet që Felix Magath ka refuzuar Kosovën, duke treguar se në listën e pesë trajnerëve, të gjithëve u kanë bërë ofertë, mirëpo ende nuk kanë marrë asnjë përgjigje. "Të gjithë janë ende opSION, kemi bërë ofertat, por ende s'kemi marrë përgjigje nga asnjë prej këtyre pesë trajnerëve". Ndërkohë, pritet që Kosova të zhvillojë



miqësoret e marsit me trajner të ri. Kujtojmë, se me 29 mars, "Dardanët" do përballen me Zvicrën.





Në pajtim me nenin 62 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Paneli për përzgjedhjen e anëtarit (ekspert i jashtëm) të Komitetit të Auditimit të BQK-së, i emëruar nga Bordi i BQK-së, publikon:

### Shpallje

Për plotësimin e një pozite të anëtarit (ekspert i jashtëm) të Komitetit të Auditimit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Profili i kërkuar:

- Person me integritet dhe përgatitje universitare;
- Minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e kontabilitetit ose auditimit;
- Njohuri në krijimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të rëndësishme të lidhura me misionin, objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Në mënyrë specifike të plotësojnë kushtet sipas nenit 40 paragrafët 2, 3 dhe 4 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-në;
- Njohja e gjuhës angleze paraqet përparësi.

Emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar nga data e emërimit.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV me detaje dhe një letër motivuese përmes email adresës vijuese: [paneli@bqk-kos.org](mailto:paneli@bqk-kos.org) ose në dorë në zarf të mbyllur në arkivin e BQK-së, Rruga Garibaldi nr. 33 në Prishtinë, ose përmes postës në adresë të BQK-së: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (shënim: për pozitën e anëtarit (ekspert i jashtëm) të Komitetit të Auditimit të BQK-së, Rruga Garibaldi nr. 33, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Afati i fundit për aplikim është 15 shkurt 2022, në orën 16:00.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit do të thirren për intervistë.



U skladu članom 62 Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo (CBK), Komisija za izbor člana (spoljnog stručnjaka) Komisije za reviziju CBK-a, imenovanog od Odbora CBK-a, objavljuje:

### Oglas

Za popunjavanje pozicije člana (spoljnog stručnjaka) Komisije za reviziju Centralne banke Republike Kosovo

Traženi profil:

- Lice sa integritetom i univerzitetskom spremom;
- Najmanje deset (10) godina profesionalnog ili akademskog iskustva u oblastima računovodstva ili revizije;
- Znanje za kreiranje i praćenje sprovođenja važnih politika u vezi sa misijom, ciljevima i zadacima CBK-a;
- Da ispunjava na specifičan način uslove iz člana 40 stav 2, 3 i 4 Zakona br. 03/L-209 o CBK;
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Imenovanje ima mandat od pet godina sa početkom od dana imenovanja.

Zainteresovani kandidati treba da dostave CV sa detaljima i motivaciono pismo na sledeću e-mail adresu: [paneli@bqk-kos.org](mailto:paneli@bqk-kos.org) ili lično u zatvorenoj koverti u arhivi CBK, Ul. Garibaldi br. 33 u Prištini, ili poštom na adresu CBK-a: Centralna banka Republike Kosovo (napomena: za poziciju člana (spoljnog stručnjaka) Komisije za reviziju CBK-a, Ul. Garibaldi br. 33, 10000 Priština, Kosovo.

Zadnji rok za apliciranje je 15. februar 2022. godine do 16 časova.

Na intervju će biti pozvani samo kandidati koji ispunjavaju uslove konkursa.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Avdyll Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës fillore "Ganimete Tërbeshi" Llukar KK Prishtinë.

► "Rima Engineering Group" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 71169790 si dhe nr fis: 601268718.

► Ardian Gashi Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Sinavere Halimi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Samidin Emini " Kuk.

► Azar Kapllani shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Arben Hashi shpall te pavlefshme diplomën shmlt " Ymer Prizreni " Prizren.

► Valdete Olloni Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

► Florid Kurhaski Crmjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. "Ali M Hasi" nga kl. I, V dhe VI-IX.

► Esat Shala shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.L.T. "Arkitekt Sinani" (ish Boris Kidric).

► Valentina Krasniqi shpalle te pavlefshme dëftesat, diplomën d he certifikatën e ShMLT "Arkitekt Sinani".

► Valbone Catovic shpalle te pavlefshme diplomën me numër 096/19 te lëshuar nga qendra Diakonie Training Center.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

